

Njoftim për fillimin e procedurës së verifikimit e plotësimit të kriterëve të kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024, nga Komisioni i Përkohshëm

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me anë të vendimit Nr. 67, datë 09.02.2023 ka vendosur ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kandidatëve për në provimin e pranimit në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për kancelar dhe/ose për ndihmës ligjor për vitin akademik 2023-2024.

Në mbështetje të procedurave dhe afateve të parashikuara në vendimin nr. 424, datë 12.10.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor *“Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të rekrutimit të kandidatit për kancelar, për këshilltar ose për ndihmës ligjor”*, ju njoftojmë se Komisioni i Përkohshëm ka filluar verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët që kanë aplikuar për në Programin e Formimit Fillestar për vitin akademik 2023-2024, për ndihmës ligjor.